

V E N D I M
Nr. 347, datë 11.7.2002

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA INSTITUTI I
SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, DHE MASËN E MBULIMIT TË ÇMIMIT
TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 15 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së barnave që rimbursohen, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Masa e mbulimit të çmimeve të listës së barnave që rimbursohen, sipas grupeve, është si më poshtë vijon:
Sipas klasifikimit, ATC e grupuar, është në masën 50 për qind deri në 100 për qind.

Grupi I - Masa e mbulimit 100 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat me nivelin më të lartë të rimbursimit dhe bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: J04, L01, L02, L03, L04, M05, V03.

Konkretisht:

- antimykobakterialët;
- barnat antineoplazikë;
- barnat në terapinë endokrine;
- imunostimuluesit;
- imunosupresivët;
- barnat për çrregullimet e sistemit muskulo-skeletik;
- të gjitha produktet e tjera terapeutike.

Grupi II - Masa e mbulimit 85 për qind deri në 95 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A09, A10, B01, B03, H01, H05, M04, N03, N04, N07.

Konkretisht:

- digjestivët, përfshi enzimët;
- antidiabetikët;
- antikoagulantët;
- hormonet e hipofizës dhe hipotalamusit;
- kalcium hemeostatikët;
- preparatet antigutozë;
- antiepileptikët;
- antiparkinsonikët;
- barnat e tjera për sistemin nervor.

Grupi III - Masa e mbulimit 75 për qind deri në 85 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: C01, C02, C04, C08, C09, H03, J05, N05, R03.

Konkretisht:

- barnat në terapitë kardiake;
- antihipertensivët;
- vazodilatatorët periferikë;
- kalcioblokuesit;
- barnat vepruese në sistemin renin-angiotensin;
- barnat në terapinë e tiroides;
- barnat antivirale, sistemike;

- psikoleptikët;
- antiastmatikët.

Grupet IV - Masa e mbulimit 65 për qind deri në 75 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A02, A07, B05, C03, C07, C10, G01, G02, G04, H02, N02, N06.

Konkretisht:

- antiacidët, barnat për mjekimin e ulçerës peptike dhe flatulencës;
- antidiarrikët, antiinflamatorët dhe antiseptikët intestinalë;
- zëvendësuesit e plazmës dhe perfuzionet;
- diuretikët;
- betablokuesit;
- barnat për reduktimin e lipideve në gjak;
- antiinfektivët dhe antiseptikët gjinekologjikë;
- barnat e tjera gjinekologjike;
- urologjikët;
- kortikosteroidët sistemike;
- analgjezikët;
- psikoanaleptikët.

Grupi V - Masa e mbulimit 55 për qind deri në 65 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A03, A05, A11, B02, C05, G03, J01, J02, M01, P02, R05, S01.

Konkretisht:

- barnat antiseptike, antikolinergjike dhe propulsivë;
- kolagogët dhe hepatoprotektorët;
- vitaminat;
- antihemorgjikët;
- vazoprotektorët;
- hormonet seksuale dhe modulatorët e sistemit gjenital;
- antibakterialët sistemike;
- antimykotikët sistemike;
- antiinflamatorët dhe antireumatikët;
- antihelmintikët;
- barnat kundër kollës dhe rrufës;
- barnat oftalmikë.

Grupi VI - Masa e mbulimit 50 për qind

Në këtë grup përfshihen barnat që kanë nivelin më të ulët të rimbursimit dhe që bëjnë pjesë në këto grupe terapeutike: A06, A12, D01, D06, D07, R01, R06, V07.

Konkretisht:

- laksativët;
- shtesat e kripërave minerale;
- antimykotikët dermatologjikë;
- antibiotikët dhe kimioterapeutikët dermatologjike;
- preparatet dermatologjikë;
- preparatet dermatologjike të kortikosteroideve;
- preparatet nazale;
- antihistaminikët sistemike;
- të gjitha produktet e tjera joterapeutike.

3. Masa e mbulimit të çmimeve të barnave të reja alternative të pasqyrës II, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, është 50 për qind.

4. Efekti financiar prej 280 000 000 (dyqindetëdhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Çdo disbalancim financiar të përballohet nga fondi rezervë i këtij Instituti.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, i cili përcakton kufizimet në përdorimin e barnave të kësaj liste, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi nr. 307, datë 12.5.2001 i Këshillit të Ministrave “Për listën e barnave që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko